



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash

04 100/01-29063/23  
20.10. 2023  
Dragash - Dragash

Nr. 01/23  
Datë: 20.10.2023  
Dragash

## Thirrje publike për propozime me bashkëfinancim

Organizatat Jo-Qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, sociale, kujdesit për qytetarët, kujdesit mjedisorë, ambiental, agrarë dhe edukimit, të aplikojnë për mbështetje financiare me bashkëfinancim.

### Qëllimi

Me anë të këtij projekti synohet mbështetja e të gjithë qytetarëve të Komunës së Dragashit në kujdesin shëndetësor, edukimin shëndetësor, kujdesin mjedisorë dhe agrarë, social, edukativo arsimor.

Të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të qytetarëve, përmirësimin e mirëqenies, përkrahjen me shërbime, ofrimin e shërbimeve të specializuara shëndetësore ndaj personave të moshuar në nevojë, të sëmurët kronikë dhe personat me nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuara duke përfshi edhe fëmijët, invalidët e luftës etj.

### Kushtet për aplikim:

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave Jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës,
- Të jenë të regjistruar dhe aktive sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të ketë kryer të gjitha detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës

- Të mos jetë në proces falimentimi, në proces të shuarjes, në procedura të mbledhjes së detyrueshme apo likuidimit;
- Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikanti duhet të jetë së paku 20% e vlerës totale të projekt-propozimit;
- Të posedojë licencë valide nga Ministria e Shëndetësisë për shërbime mjekësore dhe licencë për shërbime sociale të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Organizatat aplikuese të posedojnë edhe aktivitete në fushën e edukimit apo administrimit, mbrojtjes së ambientit, kujdesin social dhe të kenë experience në projekte të ngjajshme të dëshmuara me kontrata dhe referenca.
- OJQ-të, mund të aplikojnë vetëm me një projekt, me kohe të caktuar prej 12 muajve, duke e përshkruar dhe detajuar mirë projektin bazuar në qëllimet e thirrjes dhe detajimin e buxhetit për bashkëfinancim.

### **Organizatat përfituese**

Përfitues do të jetë një Organizatë Jo-Qeveritare.

### **Kohëzgjatja e aplikimit**

Afati për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë**, nga data **20.10.2023** dhe përfundon më datën **09.11.2023** në ora **15:00**.

Projekt propozimet duhet të dorëzohen në kopje fizike në zyrat e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Dragashit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakomletuara nuk do të pranohen.



Drejtor i SHMS-së  
Behar Brenolli

*(Handwritten signature)*